



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Drejtoria për Shërbime Publike
Uprava za Javne Službe/Directorate of Public Service

Data/Datum/Date:	16.12.2022
Nr.Br.No:	08/20
Për/ Za/To:	Kuvendin e Komunës së Shtimës
Përmes/Preko/Through:	ZKF-z.Bujar Ferati
Nga/Od/From:	Drejtoria për Shërbime Publike Drejtori i Drejtorisë: Bardhyl Rushiti
Lënda/ Predmet/Subject:	Propozim Vendim për ngritjen e çmimeve të shërbimeve të KRM “PASTËRTIA” SH.A. Ferizaj - Njësia Shtime

Bazuar në Kërkesën me Nr.prot: 4385 datë:14.09.2022 të Kompanisë Regjionale të Mbeturinave “PASTËRTIA” SH.A Ferizaj - njësia Shtime për ngritjen e çmimeve të shërbimeve si rezultat i arsyeve të cekura në kërkesën e lartcekur e të cilën e gjeni të bashkangjitur, i propozojmë Kuvendit të Komunës së Shtimes miratimin për ndryshimin e nenit 8.7 të Rregullores për Tarfia Gjoba dhe Ngarkesa për vitin 2023 dhe vendosjen e çmimeve si në vijim:

Lista dhe Tabela me tarifrat e aplikuara dhe me ato të propozuara

Kategoria e klientëve	Çmimi aktual (pa TVSH)	Propozimi për çmim të ri (pa TVSH)
Amvisëritë	4.31	5.99
Bizneset me tarifa kat.1	6.9	9.59
Bizneset me tarifa kat.2	9.74	13.54
Bizneset me tarifa kat.3	16.98	23.6
Bizneset me kontratë 1.1m³	11.21	15.58
Bizneset me kontratë 5.0m³	47.56	66.11

Bashkangjitur gjeni Kërkesën e KRM “PASTËRTIA” SH.A. FERIZAJ- njësia SHTIME.



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

Kompania Regionale e Mbeturinave/ Regional Waste Company/ Regionalna Kompanija za Uklanjanja Otpada



KRM "PASTËRTIA" SH.A. FERIZAJ

Rr. "Enver Topalli" Nr. 47 Tel. 0290/325-025

Për	Z.Bardhyl Rushiti, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Shtime
Nga	Z. Basri Sula, Kryeshef Ekzekutiv, KRM "Pastërtia" Ferizaj
Përmes	Z. Osman Muharremi – Përgjegjës i Njësisë Operative - Shtime
Lënda	Kërkesë për propozim të ngritjes së çmimeve të shërbimeve
Datë	14 Shtator 2022

I nderuar Drejtori i DSHPE z. Bardhyl Rushiti

Duke u nisur nga fakti që KRM "Pastertia" viteve të fundit është duke u ballafaquar me vështirësi financiare, dhe mbi të gjitha tani më së fundmi kur niveli i çmimeve për furnizimet bazë e të cilat janë kryesore për nevojat e KRM "Pastërtia" Sh.A. janë pothuajse dyfishuar, në vend se kompania të këndellet dhe të rimarrë veten, ne edhe më tej po thellohem në këto vështirësi.

Shpenzimet e mëdha për mirëmbajtjen e makinerisë, mungesa e kontenjerëve të ri për zëvendësimin e atyre të dëmtuarve në teren, ngritja e çmimit të vajrave dhe derivateve, pamundësia e rritjes së pagava për puntorët të cilët e kanë të vështirë të i përballojnë çmimet e shportës familjare në treg, akumulimi i borxheve ndaj furnitorëve dhe institucioneve publike, në pamundësi të pagesave të tatimeve, dhe shumë faktorë të tjerë relevant me të cilat është duke u përballur që një kohë të gjatë KRM "Pastërtia", përkundër hezitimit për të mos e rënduar buxhetin e qytetarëve, nuk na lë rrugë tjetër pos të kërkojmë që përmes Drejtorisë tuaj të procedohet në Kuvendin Komunal të Shtimes propozimi për ngritjen e çmimeve për shërbimet e ofruara nga KRM "Pastërtia" në sektorët e amvisërisë, bizneseve dhe institucioneve.

Duke e ditur se KRM "Pastërtia" është kompani me tarifat më të ulta për shërbimet që ofrohen, dhe duke përlllogaritur një vlerë lineare për ngritjen e tarifave ekzistuese, atëherë jemi të mendimit se një ngritje e çmimit për 39% në mënyrë lineare është e arsyeshme për mbulimin e shpenzimeve të kompanisë.

E vetmja mënyrë për ti përballuar shpenzimet që e përcjellin punën e KRM "Pastërtia" është kjo e ngritjes së çmimeve, në të kundërtën, bazuar në drejtëzen e raportit shpenzime dhe të hyra. seriozisht mund edhe të rrezikohet funksionimi i kompanisë në përgjithësi.

Faleminderit paraprakisht!

Me respekt KRM "Pastërtia" Sh.A Ferizaj

Lista dhe tabela me tarifat e aplikuara dhe me ato te propozuara.

Kategoria e klientëve	Çmimi aktual (pa TVSH)	Propozimi për çmim të ri (pa TVSH)
<i>Amvisëritë</i>	4.31	5.99
<i>Bizneset me tarifa kat.1</i>	6.9	9.59
<i>Bizneset me tarifa kat.2</i>	9.74	13.54
<i>Bizneset me tarifa kat.3</i>	16.98	23.6
<i>Bizneset me kontratë 1.1m³</i>	11.21	15.58
<i>Bizneset me kontratë 5.0m³</i>	47.56	66.11